


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-4346/12
Dep.	05.12.2012
Nr. i faq.	02
Broj stranica	
Nr. pages	
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **03.12.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllt rasti** me Nr. AKK-03-2437/12, për ztr. *Rifat Krasniç* – Zavendës Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesit në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

**II. Rasti mund** të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2437-12, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2437-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Rifat Krasniç – Zavendës Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushteti Lokal në Qeverinë e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushton funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit,

konsiderohet papajtushmëri funksionesh (Neni 15 , pika 1), zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Krasniç është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Krasniç, ka dekluaruar se, ka filluar procedurat për parandalimin e konflikti të interesit.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, ztr.Krasniç, me datën 23.11.2012, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja (DPK.DPKI-03-4260/12), me informacionet e reja mbi biznesin; "Mutlu"N.P.T., në të cilat shihet se ai, tashmë, ka hequr dorë nga funksioni i tij menaxhues në këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korruptionit

Hasan Preteni / 

